REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 83/17
Datë/Datum. 30.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. 83/17

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, si dhe neni 4 pika (b) Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë autoriteti kontraktues F03, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, Kryetari i Organit Shqyrtues te Prokurimit, z. Blerim Dina me datën: 30 mars 2017, mori ketë:

VENDIM

I. **HEDHET POSHTË,** si e paafatshme ankesa e OE "MEDIATECH & PRINT"- Prishtinë, me nr. të protokolli 83/17, e datës: 24 mars 2016, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me formular dhe material tjetër të shtypur" me nr. të prokurimi: "16/456/121", të shpallur nga autoriteti kontraktues– "Korporata Energjetike e Kosovës", pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

II. **I LEJOHET,** autoritetit kontraktues – "Korporata Energjetike e Kosovës", që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me formular dhe material tjetër të shtypur", me nr. të prokurimi "16/456/121", përkitazi me këtë ankesë (nëse nuk ka ankesë tjetër).

III. Pasi qe ankesa e Operatorit Ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, për faktin se e njëjta është parashtruar tek Autoriteti Kontraktues jashtë afatit ligjor, Operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës.

ARSYETIM

Njoftimi për dhënie të kontratës lidhur për këtë aktivitet të prokurimit është publikuar me dt: 09 mars 2017. Letra standarde për tenderuesin e eliminuar i është dërguar Operatorit Ekonomik "MEDIATECH & PRINT"- Prishtinë, me 10 mars 2017. Operatori ekonomik "MEDIATECH & PRINT"- Prishtinë, me datën 17.03.2017 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues, ndërsa Autoriteti Kontraktues me datën 21 mars 2017 e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim për arsye se nuk është dorëzuar brenda afateve kohore të përcaktuara.

I njëjti Operator Ekonomik me datën 24 mars 2017 ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit, duke pretenduar se kërkesa për rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues është deponuar brenda afatit ligjor. OSHP konsideron se prej datës së njoftimit të Operatorit Ekonomik me letrën standarde për tenderues të elimininuar, me dt: 10.03.2017 deri me dt: 17.03.2017 kur është parashtruar kërkesa për rishqyrtim ne Autoritetin kontraktues kanë kaluar shtatë ditë, pra në ditën e shtatë është bërë parashtrimi i kërkesës për rishqyrtim, gjë që nuk përputhet me afatin kohor që duhet përmbajtur për parashtrim të kërkesës.

Pas shqyrtimit të shkresave nga ana e OSHP-së, duke u bazuar në nenin 4 pika b të Rregullave për Paraqitje të Kërkesës për Rishqyrtim pranë AK-ve F03 [*b)Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me vendimin për dhënie të një kontratë ose te një konkursi te projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit te projektimit që i është dërguar ankuesit*], Operatorit Ekonomik ankues "MEDIATECH & PRINT"- Prishtinë i hudhet poshtë si e pa lejuar ankesa me nr prot: 83/17, e datës 24 mars 2017, e iniciuar nga AK "Korporata Energjetike e Kosovës" pasiqe është vërtetuar se ankesa është bërë jashtë afatit ligjor.

Dhe duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur nuk mund të ushtron ankesë, por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh, pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë kërkesë-padi në Gjykatën Themelore Departamenti për Çështje Administrative.

Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit

z. Blerim DINA

Vendimi i dorëzohet:

1x1 AK-"Korporata Energjetike e Kosovës"

1x1 OE "MEDIATECH & PRINT"- Prishtinë

1x1Dhe Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim ne web-faqe te OSHP-së